

I nderuar Zoti Minister i Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës!  
Të nderuar kolegë dhe pjesëmarrës!

Autoriteti i Konkurrencës ndihet sot, në ditën e 5-vjetorit të tij, i nderuar dhe i respektuar nga vemendja dhe prezenca e përfaqësuesve të lartë të faktorëve dhe aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Në datën 3 Mars të vitit 2004 është marrë vendimi i parë i Komisionit të Konkurrencës, që shënon dhe fillimin e funksionimit si institucion i pavarur publik, i votuar nga Parlamenti dhe që raporton pranë tij.

Autoriteti i Konkurrencës nuk është vetëm një emërtim institucional, por shpreh rëndësinë e konkurrencës si një fenomen i pashmangshëm i ekonomisë së tregut. Është e sanksionuar në Kushtetutë që ekonomia shqiptare është një ekonomi e orientuar drejt tregut. Është e argumentuar teorikisht dhe e evidentuar se konkurrenca është një domosdoshmëri për funksionimin e tregut, për nxitjen e inovacioneve dhe produktivitetit, duke krijuar mundësi për rritje ekonomike dhe mirëqënien sociale. Por, jo gjithmonë tregjet funksionojnë sipas ligjësive të tyre. Sjelljet antikonkurruese të palëve në treg kanë efekt të drejtëpërdrejtë apo indirekt tek mirëqënia konsumatore. Tregu nuk është “xhungël” por ka rregulla, dhe një nga institucionet kryesore që mbikqyr respektimin e këtyre rregullave është Autoriteti i Konkurrencës.

Në këtë pesë vjetor, Autoriteti i Konkurrencës mund të sjellë raste të shumta të ndërhyrjes në treg, por jo vetëm kaq. Reagimi pozitiv ndaj kërkesave të institucionit të konkurrencës dhe rritja e numrit të ankesave nga lojtarë të tregut, tregojnë se biznesi na konsideron partnerë. Rritja e numrit të rasteve të marrjes së opinionit në procesin e hartimit të akteve normative tregojnë për rritjen e vazhdueshme të advokacisë dhe kulturës së konkurrencës. Për më tepër konfirmimi nga ana e gjyqësorit e vendimeve më të rëndësishme të Komisionit të Konkurrencës tregon se zbatimi i ligjit të konkurrencës nuk mund të realizohet me efektivitetin e duhur nëse nuk merret në konsideratë nga të gjithë aktorët institucionalë dhe të tregut.

Ashtu si vetë ekonomia edhe institucioni i konkurrencës ka përmirësuar gjithnjë e më mirë instrumentat e zbatimit të ligjit, por mbi të gjitha, rritja e transparencës dhe e profesionalizimit janë konsideruar si drejtimet kryesore të veprimtarisë sonë.

Bashkëpunimi me të gjithë lojtarët dhe institucionet publike dhe të mbrojtjes së konsumatorit janë konsideruar si hallka të rëndësishme të realizimit të objektivave në funksion të barazisë në treg për një mirëqënie më të mirë reale.

Aleati ynë i përhershëm është media, të cilat sjellin shqëtësimin e publikut si dhe janë përçues të veprimtarisë sonë. Ky bashkëpunim është një domosdoshmëri në kushtet e përfshirjes në një ekonomi gjithënjë e më globale.

Pas pesë vitesh jemi më objektivë në vlerësimin e asaj që kemi bërë mirë apo jo dhe aq mirë, sikurse mund të përcaktojmë më qartë vështirësitë dhe problematikat e rritjes. Ne jemi mbështetur nga ana e Qeverisë dhe Parlamenti Shqipëtar për rritjen e kapaciteteve njërëzore si dhe për konsolidimin profesional. Gjithashtu, jemi mbështetur nga partnerët tanë ndërkombëtarë, duke na mundësuar të jemi të barabartë midis vendeve të rajonit në diskutimin e rasteve përfshi edhe ato shqiptare.

Personalisht ndihem e privilegjuar dhe e respektuar të kryesoj Autoritetin e Konkurrencës në këtë përvjetor, të një institucioni realisht të pavarur, por me shumë sfida përpara.

Të dashur Miq! Duke ju falenderuar për praninë tuaj, Ju ftoj t'i bashkoheni diskutimit në vijim të ditës së sotme.